



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:294670

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05600638

C.nr.1593/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit N.D. nga P., të cilin e përfaqëson Mustafa Radoniqi avokat në Pejë dhe ndërhyrësve kryesor R.D. etj që të gjithë nga P., të cilët i përfaqëson Arben Kelmendi avokat në Pejë, kundër të paditurit Q.A. nga P. të cilin e përfaqëson Muhamet Ibraj avokat në Pejë, baza juridike vërtetim pronësie, dorëzim paluajthmërie dhe kompensim dëmi, vlera e kontestit 20,000.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, të autorizuarve të ndërhyrësve kryesor dhe palës së paditurës, me datën 15.04.2024 mori kurse me datën 22.04.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

-në bazë të pohimit-

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit N.D. nga P., NË TËRËSI E BAZUAR dhe VËRTETOHET se paditësit N.D. nga P., i takon e drejta e pronësisë në bazë parashkrimit fitues prej 1/1 të pjesës së njësisë kadastrale me numër P-71611071-4..... ZK P. në sipërfaqe prej 1070 m² e cila sipërfaqe realizohet nga ana veriore që kufizohet me murin faktik kah parcela fqinje 45.... nga pika A deri në pikën B në gjatësi faktike prej 14.15 m, në anën lindore kah parcela fqinje 45... nga pika B deri në pikën C në gjatësi prej 25.00 m, nga pika C deri në pikën D në gjatësi prej 28.61 m, nga pika D deri në pikën E në gjatësi prej 20.44 m, në anën jugore kah rruga publike 45.... nga pika detaje E deri në pikën 4 në gjatësi prej 12.50 m, në anën perëndimore kah parcela 45... që fillon nga pika 4 deri në pikën 3 në gjatësi prej 11.42 m, nga pika 3 deri në pikën 2 në gjatësi prej 8.67 m, nga pika 2 deri në pikën 1 në

gjatësi prej 9.75, nga pika 1 deri në pikën I në gjatësi prej 4.88 m, nga pika I deri në pikën J në gjatësi prej 16.82 m, nga pika J deri në pikën K në gjatësi prej 19.74 m, nga pika K deri në pikën L në gjatësi prej 7.61 m dhe mbyllet nga pika L deri në pikën A në gjatësi prej 9.57 m dhe DETYROHET i padituri Q.A. nga Peja që paditësit t'ia pranojë të drejtën e pronësisë në pjesën e ngastrës 4512/27 ZK Pejë të përshkruar në pikën I të këtij dispozitivi dhe të lejoj që i njëjti të regjistrohet si pronar kësaj pjese të pronës në Zyrën Kadastrale në Komunën e Pejës, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

- II. APROVOHET kërkesëpadia e ndërhyrësve kryesor R.D. etj që të gjithë nga P., NË TËRËSI E BAZUAR dhe VËRTETOHET se ndërhyrësve kryesor R.D. etj që të gjithë nga P., që u takon e drejta e pronësisë me nga 1/7 të pjesës ideale në bazë të parashkrimit fitues të pjesës së njësisë kadastrale me numër P-71611071-.... ZK P. në sipërfaqe prej 250 m² e cila sipërfaqe realizohet nga pika 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 9.75 m, nga pika 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 8.67 m, nga pika 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 11.42 m, nga pika 4 deri në pikën F në gjatësi prej 12.49 m, nga pika F deri në pikën G në gjatësi prej 18.07 m dhe nga pika G deri në pikën H në gjatësi prej 4.10 m, dhe DETYROHET i padituri Q.A. nga P. që ndërhyrësve kryesor t'ua pranojë të drejtën e pronësisë në pjesën e ngastrës 45... ZK P. të përshkruar në pikën II të këtij dispozitivi dhe të lejoj që të njëjtit të regjistrohen si pronar kësaj pjese të pronës në Zyrën Kadastrale në Komunën e Pejës, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.
- III. DETYROHET Paditësi N.D. dhe ndërhyrësit kryesor R.D. etj që të gjithë nga P., që solidarisht të paditurit Q.A. nga Peja, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të ia paguajë shumën prej 2,908 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.
- IV. HUDHET poshtë si e pa rregullt padia e paditësit N.D. nga P., me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri Q.A. nga P. që paditësit të ia lirojë pjesën e uzurpuar në sipërfaqe prej 180 m², në mënyrë që nga ana perëndimore të parcelës 45.. do ta rrënon murin e ngritur dhe ta lirojë këtë pjesë dhe të njëjtën të ia dorëzojë paditësit në afat prej 15 ditësh pas marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi, ose i padituri do të lirohet nga detyrimi për dorëzim të pjesës së

uzurpuar, në qoftë se në afatin e përcaktuar si në pikën II të këtij petitumi, paditësit të ia kompensojë shumën prej 54,000.00 euro, në emër të zhdëmtimit për uzurpim të pa ligjshëm të pjesës së uzurpuar afat prej 15 ditësh pas marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë gjykatë, me datë 20.12.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurit nga baza juridike vërtetim pronësie, me vlerë të kontestit prej 20,000.00 euro. Paditësi në padi, ka theksuar se nga i padituri në vitin 1992 me çmim prej 40.000 DM ka blerë njësinë kadastrale 45... në sipërfaqe prej 1320 m². Qysh nga momenti i shitblerjes, ka hyrë në posedim të kësaj paluajtshmërie, të cilën e ka poseduar i pa trazuar nga askush.

Ndërhyrësit kryesor, me parashtrësën e datës 17.06.2022, kanë ngritur padi kundër të paditurit, për vërtetim pronësie, sipas të cilës kanë deklaruar se paluajtshmëria e cila është objekt i kontestit, është blerë edhe nga babai i ndërhyrësve H.D., e në të cilën pjesë të parcelës 45.. kanë të ndërtuar shtëpinë e tyre familjare, ashtu që kanë propozuar që padia e tyre të aprovohet në tërësi si e bazuar.

I autorizuari i palës së paditur, qysh me përgjigje në padi, fillimisht paditësit N.D. i ka pohuar të drejtën e pronësisë si dhe gjatë tërë procedurë, kurse pasi që është lejuar parashtrësja e ndërhyrësve kryesor, po ashtu edhe këtyre të fundit u ka pohuar të drejtën e pronësisë. Pasi që palëtë paditëse dhe ndërhyrësit kanë precizuar kërkesat e tyre, i autorizuari i të paditurit, në përgjigje në padi, seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalë përfundimtare ka pohuar kërkesë padinë e precizuar e të lejuar nga gjykata, si të paditësit, ashtu edhe të ndërhyrësve kryesor.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ndërhyrësve kryesor si të bazuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri e ka pohuar kërkesëpadinë.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadisë nga i padituri, gjykata ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësit me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vendshiqimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë si dhe ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve H.M. etj.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thëniet në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga të paditurit dhe deklarimeve gjatë shqyrtimit, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që fillimisht vërtetohet se paditësi dhe vëllai i tij i ndjerë kanë blerë këtë paluajtshmëri nga i padituri në vitet e 90- ta, dhe se ndërrësit kryesor janë trashëgimtarë të radhës së parë të të ndjerit H.D., e që është vërtetuar përmes certifikatave të lindjes së ndërhyrësve kryesor dhe nuk ishte fakt i kontestuar as nga palët. Po ashtu, përmes certifikatës së pronës për parcelën 45...ZK P., u vërtetua se i padituri Q.A. është pronar i kësaj paluajtshmërie dhe mund të disponojë me të, sipas certifikatës së pronës të dt.05.04.2022.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)*”- vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

II. Lidhur me hedhjen e padisë.

Gjykata, pasi që eksperti i vlerësimit të paluajtshmërive kishte dhënë sqarimet e tij në shqyrtim kryesor, palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesor u kishte kthyer paditë në plotësim në mënyrë që të njëjtat të harmonizohen në raport me të gjeturat e ekspertëve, si atij të gjeodezisë e po ashtu edhe të ekspertit të vlerësimit të paluajtshmërive, sepse kërkesat e palëve ishin të pa çarta dhe të njëjtat nuk ishin të përmbareshme, e duke i njoftuar me pasojat procedurale, e kjo sipas aktvendimit procedural të marrë në seancën e datës 07.03.2024.

Nga pala paditëse, gjykata kishte kërkuar që të përcaktohen kufijtë dhe dimensionet gjeografike të pjesës prej 1070 m² në kuadër të parcelës 45... ZK P., si dhe të precizohet kërkesa për lirim prone dhe kompensim dëmi, se për cilën pjesë të parcelës kërkohet ky kompensim për sipërfaqen prej 180 m², ku shtrihet kjo sipërfaqe dhe në kuadër të cilës parcelë.

I autorizuari i palës paditëse, me parashtrësën e datës 07.03.2024, kishte precizuar kërkesëpadinë, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi (pjesa aprovuese) dhe pikës IV (hedhja e padisë). Gjykata ka lejuar pjesërisht këtë precizim, e vetëm sa i përket pjesës aprovuese, kurse pjesën tjetër e ka hedhë poshtë si të parregullt, sepse kjo pjesë e kërkesëpadisë ishte e paqartë, pra pala paditëse nuk kishte vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës, që lirimin e pronës dhe kompensimin të cilin e kërkonte, të saktësonte sipërfaqen e cila kërkohet, për cilën pjesë të parcelës dhe se në cilat dimensione shtrihet kjo pjesë. Pala paditëse, nuk ka vepruar në këtë mënyrë. Ajo ka precizuar sipërfaqen dhe parcelën, por nuk e ka saktësuar pjesën se nga shtrihet kjo sipërfaqe, sepse në mënyrë që kërkesa të jetë e përmbareshme, ajo duhet të jetë e çartë, pra të jepen saktë dimensionet, se ku shtrihet në teren kjo pjesë e sipërfaqes, e për të cilën kërkohet lirimi ose dorëzimi i kësaj pjesë (ashtu siç e ka qartësuar dhe specifikuar kërkesëpadinë për vërtetim pronësie).

Gjykata, palën paditëse e kishte njoftuar me pasojat procedurale nëse nuk vepron sipas vërejtjeve të dhëna nga gjykata, padia do të konsiderohet e tërhequr, e nëse e njëjta do të sjellët e pa plotësuar apo e pa rregulluar do të hedhet poshtë. Në bazë të nenin 99.2 të LPK-së përcaktohet se “Parashtrësat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit” kurse sipas nenit 102.3 të LPK – së “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori bazuar në nenin 455 e lidhur me nenin 463 të LPK- së, pasi që i padituri nuk i ka dhënë shkas kontestit, sepse qysh nga fillimi i kontestit e deri në përfundim të tij ka shprehur gatishmërinë që paditësve dhe ndërhyrësve të ua përmbush detyrimin e vet. Si shpenzime të krijuara dhe të cilat gjykata i ka pranuar palës së paditur janë, për përgjigje në padi në shumë prej 208 euro, për dhjetë seanca të mbajtura nga 270 euro për seancë e në total shumë prej 2,908 euro, e të llogaritur sipas vlerës së kontestit mbi 10,000 euro, sipas numrit tarifar 6 dhe 7 të rregullores dhe tarifës së OAK-së.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:294670, C.nr.1593/19, Dt.22.04.2024

G j y q t a r i:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së lidhur me pikën I dhe II, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.